



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 01.12.2021)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, i gjyqtarit {...}, relatore znj. Brunilda Kadi. *(shtyrë nga mbledhja plenare e datës 23.11.2021).*

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:08 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)

- 9. Marçela Shehu** (anëtare)
10. Brikena Ukperaj (anëtare)
11. Erjon Muharremaj (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashë.**
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, i gjyqtarit {...}, relatore znj. Brunilda Kadi. (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 23.11.2021).

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 1 dhjetor 2021. Të pranishëm janë të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Siç jeni në dijeni, sot nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor do merren në shqyrtim 10 çështje. Nëse nuk keni ndonjë diskutim mbi përmbajtjen e rendin, do propozoja të fillonim pa vonesë lidhur me çështjen e parë që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, i gjyqtarit {...}, relator i së cilit është znj. Brunilda Kadi.

Brunilda Kadi: Faleminderit, Kryetare!

Atëherë, në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional për vitin 2013-2016 të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimin, siç edhe janë njohur të gjithë anëtarët me

projektraportin. Unë po lexoj vetëm konkluzionet. Gjyqtari është njoftuar dhe brenda afatit ka kthyer përgjigje, duke deklaruar se nuk ka kundërshtim me projektraportin e vlerësimit.

Nga ana ime si relator, propozimi për vlerësimin e gjyqtarit për këtë periudhë është konkretisht:

Për grupkriterin “Aftësitë profesionale”, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm" dhe numri total i pikëve 97. Gjyqtari, sipas vlerësimit tim si relatore është vlerësuar maksimalisht për të gjithë nëntreguesit, përveç nëntreguesit “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”, ku ai është vlerësuar në nivelin “mbi mesatar”, duke u pikëzuar me 12 pikë.

Për grupkriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarit” propozimi është që gjyqtari të vlerësohet në nivelin "Shkëlqyeshëm" me 100 pikë, duke u vlerësuar maksimalisht për të gjithë nëntreguesit e këtij grupkriteri.

Po kështu edhe për treguesin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” ai është vlerësuar sipas propozimit në nivelin "Shkëlqyeshëm" me 100 pikë, duke u vlerësuar maksimalisht në të gjithë nëntreguesit e këtij grupkriteri.

Gjithashtu edhe për grupkriterin “Aftësitë personale dhe angazhimit profesional” propozohet që gjyqtari të vlerësohet në nivelin "Shkëlqyeshëm", numri i pikëve në total maksimal 100. Rrjedhimisht për të gjithë nëntreguesit ai është vlerësuar maksimalisht.

Në total, vlerësimi sipas propozimit është "Shkëlqyeshëm". Numri total i pikëve 397. Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit znj. Kadi!

Atëherë, ftoj kolegët nëse kanë diskutime.

Nëse jo, ftoj kolegët në miratimin e projektraportit.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 01.12.2021)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019, gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, relator z. Erjon Muharremaj.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:08 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ilir Toska*** (anëtar)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)
- 9. Marçela Shehu*** (anëtare)

10. Brikena Ukperaj (anëtare)

11. Erjon Muharremaj (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019, gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, relator z. Erjon Muharremaj.

Naureda Llagami: Kalojmë në raportin e radhës që ka të bëjë me raportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019. Relator është zoti Erjon Muharremaj.

Erjon Muharremaj: Faleminderit!

Specifika e vlerësimit të vitit 2019 për gjyqtarin {...} është se përgjatë kësaj periudhe ai ka ushtruar detyrën e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë (nga janar – dhjetor 2019).

Siç edhe ju jeni njohur me projektraportin dhe me të gjitha materialet edhe gjyqtarit i janë dërguar të gjitha aktet dhe ka shprehur dakordësinë e tij dhe nuk ka asnjë kundërshtim në lidhje me vlerësimin. Kështu që po vijoj me propozimet që kam bërë në cilësinë e relatorit.

Sa i përket kriterit të parë të “Aftësive profesionale të ndihmësmagjistratit” është propozuar që të vlerësohet me 97 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", për shkak se në nëntreguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e dokumentit ligjor”, aftësitë e tij janë vlerësuar “mbi mesataren”, duke u pikëzuar me 12 pikë. Në total për kriterin e parë propozimi është 97 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Në lidhje me kriterin e dytë “Aftësitë organizative të ndihmësmagjistratit” është propozuar pikëzimi me 98 pikë, nga 100 të mundshme, për shkak se në treguesin “Rregullshmëria, saktësia dhe plotësia e dosjes gjyqësore” propozohet të vlerësohet me 8 pikë, shkalla e aftësisë “mbi mesataren”. Pra për këtë kriter propozohet pikëzimi me 98 pikë, ndërsa niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale” nuk ka asnjë tregues që shfaq ndonjë cenim të ndonjë prej treguesve sa i përket këtij kriteri, prandaj propozohet pikëzimi maksimal prej 100 pikësh.

Në lidhje me “Aftësitë personale dhe angazhimit profesional”, në kushtet kur për të gjithë treguesit ndihmësmagjistrati është angazhuar gjatë vitit 2019 si në aktivitete që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, si dhe ka publikuar edhe artikuj dhe revista shkencore, prandaj propozohet pikëzimi maksimal me 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Në total, për të katër kriteret propozohet pikëzimi me 395 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Muharremaj!

Ftoj kolegët nëse kanë ndonjë diskutim.

Nëse jo, kalojmë ne votimin e projektraportit sipas propozimit të ardhur nga relatori.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019, gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”. (Totali 395 pikë)

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 01.12.2021)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtarit {...}, për vitin 2019, relatore znj. Brunilda Kadi (*shtyrë nga mbledhja plenare e datës 23.11.2021*).¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:08 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e gjashta në rendin e ditës.

9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jastë.*
3. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
5. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtarit {...}, për vitin 2019, relatore znj. Brunilda Kadi (*shtyrë nga mbledhja plenare e datës 23.11.2021*).

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtarit {...} dhe relatore është zonja Kadi.

Brunilda Kadi: Faleminderit, Kryetare!

Në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019, kohë në të cilën ai ka qenë duke ushtruar funksionin e gjyqtarit si i caktuar përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, propozimi im si relatore për vlerësimin është si më poshtë. Gjyqtari është njoftuar dhe brenda afatit ka deklaruar se është dakord me vlerësimin dhe nuk ka kundërshtime.

Në lidhje me grupkriterin “Aftësitë profesionale”, sipas propozimit të projektraportit, vlerësimi në total është 97 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Është vlerësuar maksimalisht në të gjithë nëntreguesit, përveç treguesit “Qartësia, konciziteti

dhe kuptueshmëria e vendimit”, ku sipas propozimit është vlerësuar në nivelin “mbi mesatar” me 12 pikë.

Për grupkriterin e “Aftësive organizative”, niveli i vlerësimit është “Shkëlqyeshëm” dhe pikët në total 96 pikë. Gjyqtari është vlerësuar maksimalisht në të gjithë nëntreguesit, përveç nëntreguesit “Plotësimi i standardeve minimale kohore”, që sipas të dhënave (burimeve të vlerësimit), sipas propozimit tim si relator, vlerësoj që duhet të pikëzohet me 4 pikë, me nivelin e vlerësimit “mbi mesatare”. Po kështu edhe “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor” në nivelin “mbi mesatar” me 12 pikë.

Në lidhje me grupkriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” propozimi është që të vlerësohet në nivelin “Shkëlqyeshëm” me pikët maksimale 100.

Për “Aftësitë personale dhe angazhimin profesional” propozimi është që të vlerësohet në nivelin “Shkëlqyeshëm” me 93 pikë në total. Gjyqtari është vlerësuar maksimalisht për të gjithë treguesit, me përjashtim të nëntreguesit “Publikimet ligjore akademike” nga ku rezulton se nuk ka të dhëna dhe është vlerësuar me 0 pikë dhe tek “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” nuk ka të dhëna, dhe sipas Metodologjisë propozohet të vlerësohet me 3 pikë.

Në total vlerësimi përfundimtar është në nivelin “Shkëlqyeshëm” dhe numri total i pikëve 386. Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit zonja Kadi!

Ftoj kolegët nëse kanë ndonjë koment apo sugjerim lidhur me projektraportin.

Brikena Ukperaj: Kryetare, kam unë një propozim.

Lidhur me treguesin e “Aftësive organizative” - “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor”, pavarësisht se gjyqtari nuk ka bërë kundërshtime, në fakt nga raporti analitik dhe nga projektraporti i vlerësimit rezulton që vetëm për dy kategori (nga tërësia e kategorive të çështjeve), afati i dorëzimit të vendimit të arsyetuar rezulton të jetë tejkaluar me një kohëzgjatje me 2 ditë, e cila në vlerësimin tim nuk mund

të ndikojë në shkallën e pikëzimit për sa i përket këtij treguesi, referuar edhe ngarkesës në punë të gjyqtarit. Pra nga analiza logjike e të dhënave statistikore, duke përjashtuar analizën matematikore, vlerësoj që duke qenë që afati është i tejkualuar me dy ditë, është një tregues i papërfillshëm për të ndikuar në pikëzimin e aftësisë së gjyqtarit për sa i përket këtij treguesi. Bëhet fjalë për kërkesat penale të hetimit paraprak. Zakonisht afati procedural i dorëzimit është 5 ditë dhe afati mesatar i arsyetimit është 7.75 ditë (pra është 2.75 ditë i tejkualuar). Vetëm tek kërkesat penale të hetimit paraprak rezulton përsëri koha mesatare e arsyetimit 4 ditë, nga 48 orë. Për këtë arsye vlerësoj që edhe për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet me 15 pikë dhe jo me 12 pikë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Brikena, dhe një herë konkretisht.

Brikena Ukperaj: “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar”, tek treguesi i “Aftësive organizative”. Është pikëzuar me 12 pikë, aftësia “mbi mesataren”. Në vlerësimin tim, marrë parasysh edhe qëndrimet e tjera që kam mbajtur për vlerësimet, vlerësoj që duhet të jetë “shumë e lartë”, me 15 pikë.

Brunilda Kadi: Mundem Kryetare?

Naureda Llagami: Po, Bruna!

Brunilda Kadi: Edhe unë si relatore jam dakord që të bëhet ky ndryshim nga projektraporti i vlerësimit. Jam dakord edhe me analizën që bëri zonja Ukperaj, por edhe nga standardi që kemi mbajtur në vijim, duke pasur parasysh që koha kur është bërë ky projektraport nga ana ime si relator, deri më sot, kanë kaluar disa vlerësime për gjyqtarë të tjerë dhe duke reflektuar qëndrimin që ka mbajtur Këshilli në rastet e ngjashme, jam dakord me atë propozim. Pra edhe nga ana ime vjen si propozim për të shtuar 3 pikë në këtë nëntregues.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse nuk kemi ndonjë sugjerim tjetër, kalojmë në votim fillimisht propozimin e zonjës Ukperaj, me të cilën u bashkua edhe zonja Kadi, pra që nga 12 pikë të shkojë në 15 pikë “Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar”. Jemi dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Pra në total na shkon nga 386 pikë, në 389 pikë.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
- Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ilir Toska: Më fal, duhet ta votojmë raportin në tërësi sepse nuk e kemi votuar. Votuar vetëm propozimin e zonjës Ukperaj, bashkë me zonjën Kadi, por nuk kemi votuar të gjithë raportin.

Naureda Llagami: Po, ke të drejtë Ilir. Ndjesë!

Atëherë, kalojmë edhe një herë raportin në tërësi.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 01.12.2021)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtarit {...}, për vitin 2019, relatore znj. Brunilda Kadi (*shtyrë nga mbledhja plenare e datës 23.11.2021*).²

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:08 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e shtata në rendin e ditës.

9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.*
3. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
5. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtarit {...}, për vitin 2019, relatore znj. Brunilda Kadi (*shtyrë nga mbledhja plenare e datës 23.11.2021*).

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër që edhe kjo ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtarit {...}, për vitin 2019. Edhe për këtë relatore është zonja Kadi.

Brunilda Kadi: Faleminderit, Kryetare!

Në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019, nga ana ime është realizuar projektraporti i vlerësimit. I është njoftuar gjyqtarit, i cili ka deklaruar brenda afatit se është dakord dhe nuk ka kundërshtime. Për këtë vit që është vlerësuar gjyqtari, ai ka qenë duke ushtruar funksionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Sipas propozimit në këtë projekt, vlerësimi sipas relatorit është si vijon:

Për “Aftësitë profesionale”, propozohet të vlerësohet në nivelin "Shkëlqyeshëm", me 97 pikë, duke u vlerësuar maksimalisht në të gjithë nëntreguesit, përveç nëntreguesit “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”.

Në “Aftësitë organizative”, propozimi është që gjyqtari të vlerësohet "Shkëlqyeshëm" dhe pikët në total 94. Është propozuar të vlerësohet maksimalisht tek të gjithë nëntreguesit, me përjashtim të nëntreguesit “Respektimi i afateve ligjore”, ku propozohet të vlerësohet në nivelin “mbi mesatar” me 12 pikë dhe për “Kohën mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor” ku është propozuar të vlerësohet në nivelin “mbi mesatar” me 12 pikë.

Për sa i përket grupkriterit “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” është propozuar që të vlerësohet në nivelin "Shkëlqyeshëm" me pikët maksimale 100, duke u vlerësuar maksimalisht tek të gjithë nëntreguesit.

Për grupkriterin “Aftësitë personale dhe angazhimit profesional” është propozuar të vlerësohet në nivelin "Shkëlqyeshëm" me 93 pikë në total, duke u vlerësuar maksimalisht tek të gjithë nëntreguesit, me përjashtim të nëntreguesit “Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, ku ka rezultuar sipas burimeve të vlerësimit që nuk ka të dhëna për këtë angazhim, duke u pikëzuar sipas Metodologjisë vetëm me 3 pikë. Dhe tek “Publikimet ligjore akademike” nuk ka rezultuar që ka të dhëna, 0 pikë.

Në total, niveli përfundimtar i vlerësimit propozohet të jetë "Shkëlqyeshëm" me pikët totale 384. Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit zonja Kadi!

Ftoj kolegët nëse kanë ndonjë diskutim lidhur me projektraportin, apo sugjerim, koment.

Maksim Qoku: Kryetare, kam propozim.

Naureda Llagami: Po Maksi!

Maksim Qoku: Tek grupkriteri i parë “Aftësitë profesionale”, nënndarja B. “Arsyetimit ligjor”, nënndarja a. “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”, propozoj vlerësim maksimal, pra nga 12 pikë në 15 pikë.

Gjithashtu tek grupkriteri i dytë “Aftësitë organizative”, tek nënndarja A.d. “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor”, propozoj edhe këtu vlerësimin maksimal nga 12 pikë në 15 pikë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit Maksi!

Marçela Shehu: Mundem Kryetare?

Naureda Llagami: Po, Marçela!

Marçela Shehu: Faleminderit!

Atëherë, unë bashkohem me një nga propozimet e zotit Qoku, konkretisht bashkohem me propozimin e tij që tek “Aftësitë profesionale”, nëntreguesi i “Arsyetimit ligjor”, “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”, gjyqtari të vlerësohet maksimalisht, pra nga 12 pikë në 15 pikë, duke vlerësuar që në tërësinë e tij, pavarësisht se çfarë është parashtruar në raportin analitik, mënyra e të shkruarit të arsyetimit të gjyqtarit nuk e cenon kuptueshmërinë e vendimit, që për mua bën pjesë tek gjyqtarët që ka një nivel të lartë akademik dhe pavarësisht mënyrës pak të zgjatur apo parashkrimit të gjatë të ligjit apo të jurisprudencës, e gjithë kjo situatë nuk e cenon në konkluzion kuptueshmërinë e vendimit të gjyqtarit.

Gjithashtu unë do të propozoja që tek “Aftësitë personale dhe angazhimit profesional”, tek nëntreguesi “Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun të gjykata”, gjyqtari të vlerësohet maksimalisht me 5 pikë, duke konsideruar këtu faktin gjyqtari rezulton të jetë kryetari i Shoqatës së Gjyqtarëve (ky është një fakt i njohur botërisht). Kështu që, duke pasur në konsideratë dhe qëndrimin që kam mbajtur në situata të tjera, për shembull në rastin e z. Kalaja, unë propozoj që ky angazhim i zotit {...}, të

konsiderohet edhe për këtë nëntregues. Kështu që nga vlerësimi 3 pikë, gjyqtari të vlerësohet me vlerësimin maksimal 5 pikë.

Faleminderit Kryetare!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit Marçela!

Atëherë, kalojmë fillimisht propozimet për rritjen e pikëve sipas radhës.

Kështu fillojmë me propozimin e parë që ka të bëjë me “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”, propozim i zotit Qoku dhe zonjës Shehu, nga 12 pikë në 15 pikë. Jemi dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Kundër, pasi jam dakord me vlerësimin që ka bërë relatorja, znj. Kadi.

Brikena Ukperaj: Kundër, pasi jam dakord me vlerësimin e relatores.

Medi Bici: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet propozimi, nga 12 pikë shkon në 15 pikë.

Naureda Llagami: Shkojmë në propozimin e radhës që ka të bëjë me “Kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor”, i cili është vlerësuar nga relatorja “mbi mesatar”, ndërkohë që propozimi i zotit Qoku është që të vlerësohet maksimalisht me 15 pikë. Jemi dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Kundër.

Erjon Muharremaj: Kundër.

Brikena Ukperaj: Pro, sepse një qëndrim i ndryshëm bie në kundërshtim me atë vendim që sapo morëm për zotën {...}. Edhe pse zoti Qoku nuk e sqaroi, në fakt po të shikohet raporti i vlerësimit, tejkalimi i afateve të arsytimit të vendimit të gjyqtarit është vetëm për dy kategori dhe është me 1 ditë ose me 0.5 ditë. Prandaj votoj pro.

Medi Bici: Pro. Jam i të njëjtit mendim me Brikenën.

Naureda Llagami: Dakord.

Ky propozim nuk miratohet.

Naureda Llagami: Kalojmë në propozimin e zonjës Shehu, i cili ka të bëjë me vlerësimin e kriterit “Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun të gjykata”, ku sipas propozimit është nga 3 pikë që e ka vlerësuar relatori, të shkojë në 5 pikë. Jemi dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord, edhe me arsytimin që Këshilli në raste të ngjashme ka mbajtur qëndrimin që është vlerësuar ky lloj angazhimi.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

(Miratohet propozimi i zonjës Shehu.)

Naureda Llagami: Atëherë, në tërësi u shtuan 5 pikë.

Hedhim në tërësi raportin, nga 384 ka shkuar në 389 pikë. Niveli është i njëjtë, "Shkëlqyeshëm". Hedhim në votim raportin.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit

nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 01.12.2021)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, i gjyqtarës {...}, relatores znj. Brikena Ukperaj.³

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:08 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

³ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e teta në rendin e ditës.

9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashë.*
3. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
5. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, i gjyqtarës {...}, relatore znj. Brikena Ukperaj.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e radhës e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për gjyqtarën {...}. Për më shumë detaje fjalën ia jap zonjës Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Gjyqtarja {...}, gjatë vitit 2013-2016 ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, njëkohësisht ka mbajtur edhe detyrën e kryetares së gjykatës.

Në pjesën e parë të projektraportit të vlerësimit, përshkruhet në mënyrë të detajuar qëllimi dhe burimet e vlerësimit. Tek burimet e vlerësimit dua të ndalem në dy të dhëna që janë marrë parasysh veç akteve që ka pasur dosja e vlerësimit e dërguar nga organet e rivlerësimit. Kanë qenë dy praktika të referuara nga ish-Inspektorati i KLD-së lidhur me

zvarritje të gjykimit, ku është evidentuar kohëzgjatja e gjykimit tej standardeve minimale dhe pasi është bërë analiza, është konkluduar që ato nuk përbënin arsye për fillim të procedimit disiplinor, por mënyra se si gjyqtarja kishte menaxhuar procesin dhe mënyra se si ishte sjellë për të disiplinuar palët, duhet të ndikonte në vlerësimin etik dhe profesional. Për këtë arsye, në projektraportin e vlerësimit gjenden të analizuara edhe këto dy praktika të përcjella nga ish-Inspektorati i KLD-së.

Duhet të kemi parasysh që pas konfirmimit të gjyqtares me vendim të formës së prerë nga organet e rivlerësimit, çështja është bërë objekt shqyrtimi në Kolegjin e Apelit, por duke marrë parasysh që është bërë ankim vetëm për kriterin e pasurisë, çështjet e vlerësimit etik dhe profesional nuk janë marrë në shqyrtim nga ky kolegji dhe në këtë kuadër edhe denoncimet e publikut nuk janë marrë në shqyrtim lidhur me ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore. Në dosjen e vlerësimit profesional janë vetëm vendimet gjyqësore, denoncimet e publikut të administruara në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares, siç kanë rezultuar në fazën e parë, pra pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Të gjitha këto vendime janë administruar gjatë këtij procesi të vlerësimit etik dhe profesional dhe përshkruhen në mënyrë të hollësishme në pjesën e parë të projektraportit, i cili bën fjalë për burimet e vlerësimit.

Para se të filloj me relativimin e propozimit që në cilësinë e relatores kam sot për mbledhjen plenare, dua të evidentoj faktin që gjyqtarja pasi është njohur me projektraportin e vlerësimit ka paraqitur kundërshtime. Në mënyrë specifike kundërshtimet e gjyqtares nuk i referohen treguesve të caktuar por ajo paraqet disa shkaqe që kërkon nga mbledhja plenare që të merren parasysh, për ta çuar në një nivel më të lartë pikëzimi, kryesisht sa i përket aftësive të saj organizative, në treguesit ku unë si vlerësues kam mbajtur qëndrimin që vlerësimi i aftësive organizative të saj nuk duhet të çmohet në shkallën maksimale.

Për sa i përket “Aftësive profesionale të gjyqtares”, “Njohuritë ligjore”, “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” propozimi është që vlerësimi të jetë në shkallën e aftësisë “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë, pasi evidentohet aftësia shumë e mirë e saj në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes si dhe

identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes/çështjes penale.

Për sa i përket “Aftësisë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, ka një ndryshim thelbësor midis çështjeve penale dhe çështjeve civile, pra duket që gjyqtarja nuk i ka kushtuar të njëjtën rëndësi analizës së normës para zbatimit të saj mbi faktet e provuara. Për këtë arsye kam vlerësuar se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në këtë tregues duhet të vlerësohet “mbi mesataren” duke u pikëzuar me 20 pikë. Konkretisht, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi mbi mesatare, në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Interpretimi i ligjit procedural dhe posaçërisht atij material në zgjidhjen e çështjes, rezulton vetëm në disa nga vendimet burim vlerësimi, ndërsa në pjesën tjetër dispozitat referohen (në disa raste edhe jo) dhe zbatohen drejtpërdrejt në mbi faktet e çështjes, pa u bërë më parë një interpretim paraprak i tyre në drejtim të identifikimit të qëllimit, elementëve përbërës dhe zërthimit të normës. Gjithashtu, nuk evidentohet në asnjë rast identifikimi dhe referimi në praktikën gjyqësore relevante (me përjashtim të vendimit unifikues mbi gjykimin e shkurtuar), çka do t'i jepte vlerë të shtuar interpretimit të ligjit, në mbështetje të konkluzioneve të arritura mbi zbatimin e tij, kushtëzuar kjo edhe nga natyra e çështjeve të cilat paraqiten përgjithësisht dhe që nuk janë në tërësinë e tyre jo komplekse. Duke iu referuar burimeve të vlerësimit në tërësi, rezulton se interpretimi dhe analiza e normave nuk reflekton të njëjtën shkallë kujdesi në të gjitha vendimet pasi gjyqtarja kryesisht referon dhe aplikon drejtpërdrejt ligjin mbi faktet e provuara, duke i lidhur ato me konkluzionet e arritura, por nuk ndalet në interpretimin e ligjit dhe dhënien e arsyes konkrete për mënyrën e zbatimit të tij mbi faktet e çështjes.

Për sa i përket “Qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit”, vendimet janë të qarta, koncize, të kuptueshme. Shkalla e aftësisë propozohet “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

Për sa i përket “Strukturës së qëndrueshme dhe të mirëorganizuar e vendimit”, gjyqtarja ka një metodologji konstante në ndjekjen e strukturimit të vendimit dhe në arsyetimin e vendimeve. Të gjitha vendimet kanë një strukturë të njëjtë, të mirë

përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, çka i bën vendimet lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme dhe orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre. Propozohet vlerësimi me 10 pikë, shkalla e aftësisë “shumë e lartë”.

Për sa i përket “Cilësisë së analizës dhe e argumentimit logjik”, nga burimet e vlerësimit rezulton se cilësia e analizës dhe argumentimit logjik, përmbush në përgjithësi standardet e procesit të rregullt ligjor si dhe jep përgjigje të argumentuar për pretendimet e palëve, duke mbështetur konkluzionin për zgjidhjen e çështjes. Evidentimi i faktit penal nuk mbështetet në një analizë të detajuar dhe të integruar të provave të marra në gjykim, çka nuk i jep cilësi të lartë analizës dhe argumentimit logjik. E njëjta shkallë aftësie konstatohet edhe në aspektin e arsytimit të mënyrës se si ligji zbatohet mbi faktet e provuara. Ky proces i dytë i metodologjisë së të shkruarit të mendimit juridik, bazohet më shumë në deduksione logjike sesa analizë ligjore. Duke iu referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se gjyqtarja nuk ka treguar të njëjtën shkallë kujdesi në drejtim të analizës dhe argumentimit logjik. Procesi analitik i vlerësimit të provave dhe shkalla e interpretimit të ligjit të zbatueshëm, në raport me analizën e marrëdhënies shkak-pasojë si dhe zbatimin të dispozitave ligjore mbi faktet e çështjes, evidenton dukshëm një shkallë të ndryshme aftësie të gjyqtarës në lidhje me këtë tregues duke u dominuar vendimet burim vlerësimi nga elementi përshkruar në raport me atë analitik. Për këtë arsye kam propozuar që shkalla e aftësisë së gjyqtarës duhet të vlerësohet “mbi mesataren”, duke u pikëzuar me 20 pikë.

Përfundimisht, për kriterin e parë “Aftësitë profesionale të gjyqtarës”, niveli i vlerësimit propozohet "Shkëlqyeshëm", dhe 90 pikë.

Për sa i përket “Aftësive organizative të gjyqtarit”, referuar burimeve të vlerësimit të cilave ne iu referohemi në procedurën e gradimit, për sa i përket “Respektimit të afateve ligjore” nuk ka rezultuar asnjë çështje nga ato që janë analizuar në kuadër të këtij treguesi për të cilin ligji të ketë parashikuar afat ligjor shqyrtimi. Për këtë arsye kemi zbatuar parimin e prezumimit si dhe në raste të tjera, dhe duke qenë se kjo përqindje rezulton 0%, prezumohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në respektimin e afateve ligjore, duke u pikëzuar me 15 pikë.

Për sa i përket “Plotësimin të standardeve minimale kohore”, në mënyrë të detajuar në raport, gjeni në mënyrë të detajuar shpjegimin lidhur me kohëzgjatjen e gjykimeve për të gjitha çështjet që janë analizuar, përfshirë këtu edhe të çështjeve të referuara nga ish-Inspektorati i Lartë i KLD-së për vlerësimin etik dhe profesional. Në tërësi, duke përfshirë muajt e lejes vjetore apo ato të pushimeve të tjera, ka rezultuar që afati i shqyrtimit të çështjeve, si mesatare e të gjitha çështjeve, rezulton që të jetë 25% e çështjeve tej standardit minimal të miratuar. Nga ana tjetër, për këtë periudhë trevjeçare vlerësimi, gjyqtarja ka përfunduar 1049 çështje, nga të cilat 472 çështje themeli në tre vite, mesatarisht 157 çështje themeli në vit, ndërkohë që duhej të shqyrtonte jo më pak se 80 çështje në vit, duke tejkaluar këtë standard me 77 çështje në vit ose në masën 96%. Në këtë llogaritje mbahet parasysh fakti që si drejtuese e gjykatës, standardi minimal sasior orientues për të ishte në masën 40% të ngarkesës minimale të punës së gjyqtarit të asaj gjykate.

Në këto kushte, duke marrë pikërisht parasysh përqindjen e çështjeve të shqyrtuara tej afatit (25%), faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit të cilat, nga dosjet e vëzhguara, nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit pavarësisht aftësisë së saj për të menaxhuar procesin si dhe duke marrë parasysh edhe tejkalimin e standardit sasior të zbatueshëm në masën 96%, kam vlerësuar që gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi nga kjo analizë logjike se ai që i përket analizës matematikore e të dhënave statistikore, dhe të pikëzohet me 4 pikë. Pra nga 3 pikë në 4 pikë. Megjithatë kam vlerësuar që nga analiza logjike e të dhënave nuk justifikohet niveli i pikëzimit maksimal me 5 pikë.

Për sa i përket “Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, nga të gjitha dosjet e vëzhguara rezulton që koha mesatare është me e shkurtër se standardi minimal kohor për shumicën e kategorive të çështjeve. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit kjo llogaritje matematikore përkon me një pikëzim prej 4 pikësh.

Në cilësinë e relatores, duke marrë parasysh të dhënat matematikore si dhe faktin që për një nga kategoritë e çështjeve, kryesisht çështjet civile me palë kundërshtare, koha mesatare rezulton e tejkaluar me disa muaj, pra rreth 5 muaj më tej se standardi, kam vlerësuar që për shkak edhe të kompleksitetit jo gjithmonë përcaktuar në kohëzgjatjen e

gjkimeve, nuk ka qenë rasti për të aplikuar një nivel më të lartë pikëzimi, pra nga 4 pikë në 5 pikë. Për këtë arsye propozimi vazhdon të qëndrojë në 4 pikë, pasi koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më e shkurtër për shumicën e kategorive të çështjeve, por nga analiza logjike e të dhënave të burimeve të vlerësimit nuk justifikon një nivel më të lartë pikëzimi.

Për sa i përket “Rendimentit të përfundimit të çështjeve gjyqësore”, gjatë procesit të vlerësimit dhe raportit analitik ndihmës që përgatitet nga Këshilli për organet e rivlerësimit është bërë një llogaritje rendimenti në masën 84.2%. Pavarësisht se nuk ka të dhëna të tjera për të arritur në një analizë matematikore tjetër, duke marrë parasysh ngarkesën në punë të gjyqtarës në tejkalimin e standardit sasior për çështjet e themelit të përfunduara me 96%, propozoj që të përcaktohet një nivel më i lartë pikëzimi sesa ai që rezulton nga përllogaritja matematikore, por jo ai maksimal. Pra nëse 84.2% do të përkonte me një pikëzim prej 6 pikësh, referuar ngarkesës në punë, propozoj që ky vlerësim për këtë tregues të jetë me 8 pikë.

Për sa i përket “Kohës mesatare të arsyetimit të vendimit”, propozimi është për 15 pikë, pasi koha mesatare e arsyetimit është më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjes.

Për sa i përket “Numrit mesatar të seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive”, në projektraport janë analizuar ecuritë procedurale dhe sidomos të gjithë seancat gjyqësore për të gjitha çështjet të cilat janë analizuar në kuadër të këtij procesi.

Nga tërësia e të dhënave ka rezultuar se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në 12 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare (penale themeli dhe civile themeli) varion nga 3 deri në 28 seanca gjyqësore. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar 12 çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 10.6 seanca gjyqësore në çështjet civile me palë kundërshtare dhe 3.6 seanca gjyqësore në çështje penale themeli, dhe në total numri mesatar i seancave është 8.5 seanca për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Nga ana tjetër, nga vëzhgimi i dosjeve rezulton se gjyqtarja në përgjithësi ka kryer me korrektësi veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil dhe penal. Ka mbikëqyrur dërgimin pa

vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët, etj. Përgjithësisht shtyrjet e seancave kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si njoftimit i të pandehurve, njoftimi i mbrojtësve të të pandehurit, njoftimi i ekspertit, njoftimi i palëve të treta, njohja me aktet, etj.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, numrit mesatar të seancave gjyqësore 8,5 seanca dhe shkallës së kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave gjyqësore joproductive, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues duhet të vlerësohet mesatare, sepse rezultojnë në mënyrë të përsëritur seanca të shtyra për të njëjtin shkak dhe një numër i lartë seancash joproductive. Nëse do të vërehen të gjitha dosjet gjyqësore, në fakt, 50 % e seancave të zhvilluara kanë qenë joproductive. Evidentohet që në çështjet e një natyre më komplekse gjyqtarja nuk ka treguar kujdesin maksimal për zhvillimin e seancës gjyqësore produktive, pavarësisht nevojave procedurale që lidhen me ecurinë e gjykimit. Për këtë arsye kam propozuar që për këtë tregues, gjyqtarja të pikëzohet me 9 pikë.

Për sa i përket “Kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, në dosjet e vëzhguara, në përgjithësi seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa 2 deri në 15 minuta që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës e përgatitjen e sallës së gjykimit. Megjithatë konstatohet një numër i konsiderueshëm seancash të filluara me më shumë se 15 minuta vonesë, të cilat variojnë nga 20 minuta, 35 minuta, 40 minuta, 50 minuta, 1 orë e 30 minuta apo edhe deri në 2 orë e 40 minuta vonesë nga ora e planifikuar. Në 6 dosjet e përzgjedhura me short nga 28 seanca të zhvilluara gjithsej, 11 prej tyre kanë filluar me mbi 15 minuta vonesë. Ndërkohë nga 5 dosjet e përzgjedhura me short për efekt të rivlerësimit nga 41 seanca gjyqësore të zhvilluara rezulton që në total 12 prej tyre kanë filluar me vonesa mbi 15 minuta. Pra në total rezulton se 33% e seancave gjyqësore kanë filluar me vonesa të konsiderueshme duke filluar nga 16 minuta deri në 2 orë e 40 minuta. Po kështu nuk mund të përcaktohet edhe shkakun për të cilën këto seanca kanë filluar me vonesë për sa kohë shkakun i vonesave në zhvillimin e seancave gjyqësore, nuk rezulton që të jetë relativisht gjithmonë nga ana e gjyqtarës, megjithatë nuk rezulton që seancat të mos jenë zhvilluar për shkak të fillimit më vonesë të tyre.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, vlerësohet bazuar ndër të tjera, edhe në shkallën e aftësisë dhe efikasitetit të treguar nga gjyqtari në kryerjen e veprimeve për fillimin pa vonesë të seancave gjyqësore. Numri i konsiderueshëm i seancave të filluara me vonesë në këtë rast si dhe shtrirja kohore e vonesës, pavarësisht relativitetit të shkakut për palët prezent (edhe relativiteti mungon në shumicën e rasteve), është një e dhënë që në këtë rast nuk tregon shkallë shumë të lartë aftësie të gjyqtarëve, në drejtim të planifikimit dhe mbikëqyrjes së fillimit pa vonesë të seancave gjyqësore. Nga ana tjetër duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Për këtë arsye, propozimi është me 16 pikë lidhur me këtë tregues, duke e vlerësuar shkallën e aftësisë “mbi mesatare”.

Për sa i përket “Rregullshmërisë së dokumentacionit të dosjes” dhe “Saktësisë dhe plotësisë së këtij dokumentacioni”, shkalla e aftësisë është “shumë e lartë” dhe është propozuar pikëzimi në nivelet maksimale.

Përfundimisht, për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarit”, propozimi është për nivelin e vlerësimit "Shumë mirë" dhe 86 pikë.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, propozoj pikëzimin me 100 pikë. Referuar Metodologjisë, nuk ka të dhëna që mund të evidentonin në një pikëzim të ndryshëm.

Për sa i përket “Aftësive personale dhe angazhimi profesional” është vlerësuar maksimalisht për të gjithë treguesit, me përjashtim të atyre treguesve që nuk ka pasur të dhëna për “Angazhimin e gjyqtarëve në trajnimin e gjyqtarëve apo gjatë stazhit profesional”, për “Angazhimin e saj në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe marrëdhëniet me publikun”, si dhe “Publikimet ligjore akademike”. Prandaj për këtë kriter propozimi është 91 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Për të katër kriteret: “Aftësitë profesionale” propozohet pikëzimi 90 pikë, "Shkëlqyeshëm"; “Aftësitë organizative” me 86 pikë, "Shumë mirë"; “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” me 100 pikë, "Shkëlqyeshëm" dhe “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” me 91 pikë, "Shkëlqyeshëm".

Lidhur me kundërshtimet e gjyqtares, ju janë dërguar të gjithëve me shkrim. Gjyqtarja ka pretenduar që duhet të bëhet një analizë më e detajuar logjike e gjithë të dhënave burimore dhe pretendon që kjo analizë nuk mund të jetë sipërfaqësore, thjesht duke u llogaritur si një diferencë e kohëzgjatjes së shqyrtimit të çështjeve nga dita e regjistrimit me ditën e përfundimit, por duhen marrë parasysh edhe ecuria procedurale e çështjes, ku të gjitha seancat janë shtyrë konkretisht për shkak të kryerjes së veprimeve procedurale dhe për shkak të garancive që duhet të ketë një proces i rregullt ligjor.

Ka pretenduar gjithashtu që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë është gjykata e parë ku është aplikuar projekti “Për një drejtësi pa vonesa” dhe USAID dhe OSCE kanë konsideruar të suksesshëm zbatimin e këtij projekti. Duhet të evidentohet sipas gjyqtares, dhe të analizohen ndikimi i disa faktorëve në kohëzgjatje dhe në afatet e gjykimit, si mungesa e njoftimit efektiv të palëve, kërkesat për mbrojtje, moskthimet e përgjigjes nga institucionet shtetërore, koha për ekspertët, rëndësi e palëve për t’u njohur me aktet e ekspertimit. Gjithashtu gjyqtarja pretendon se cilësia e zgjidhjes së çështjes nuk është një tregues që është marrë parasysh prej vlerësuesit në vlerësim dhe pretendon që edhe fakti që vendimet e saj janë lënë në fuqi nga gjykatat më të larta, është një e dhënë që afekton aftësinë e saj organizative.

Nga ana tjetër, ka pretenduar gjithashtu që menaxhimi i çështjeve nga ana e saj ka qenë maksimal sepse për të respektuar afatin 15-ditor në çështjet penale i është dashur që të caktojë një numër shumë të lartë seancash gjyqësore në ditë dhe kjo ka sjellë pastaj deri në 20-30 seanca, dhe kjo ka sjellë pastaj që seancat të shtyhen dhe të mos zhvillohen në orarin e planifikuar.

Nuk ngrihen pretendime në kundërshtimet e gjyqtares lidhur me kriterin e parë dhe treguesit e këtij kriteri që kanë të bëjnë me aftësitë profesionale të gjyqtares. Në cilësinë e relatores nuk kam propozim tjetër për sa i përket kriterit të parë të “Aftësive profesionale të gjyqtares”. Vlerësoj që në projektraport është shpjeguar në mënyrë të

detajuar arsyet për të cilat gjyqtarja është vlerësuar me nivelin mbi maksimal tek “Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik” dhe tek “Arsyetimi ligjor”.

Për sa i përket “Aftësive organizative të gjyqtarës”, në cilësinë e relatores vlerësoj se nuk është vendi për të propozuar një ndryshim në pikëzimin e treguesve të këtij kriteri, për sa kohë nuk kemi të dhëna të tjera statistikore të cilat mund të merreshin parasysht për të bërë një analizë të ndryshme të të dhënave matematikore, dhe nga ana tjetër, nuk janë fakte të reja të cilat unë si vlerësuese nuk i kam marrë parasysht kur kam bërë analizën logjike të të dhënave statistikore. Duhet sqaruar se ligjshmëria e vendimmarrjes së gjykatës, e domosdoshme në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, është e ndryshme nga aftësia e gjyqtarit për të menaxhuar çështjen në aspektin e përdorimit sa më të mirë të kohës dhe drejtimit të hetimit gjyqësor. Vlerësuesi nuk ndërhyt në çështje që lidhen me zbatimin e dispozitave procedurale në kuadër të procesit të rregullt ligjor. Sigurisht që ky i fundit nuk mund të përfundojë pa pasur një njoftim të rregullt të palëve, pa u respektuar e drejta e tyre për t’u dëgjuar apo për t’u mbrojtur sepse nëse këto të fundit nuk respektohen, potencialisht mund të shtrohen diskutime për shkelje disiplinore të gjyqtarit. Aftësia organizative e gjyqtarit shkon përtej kësaj. Gjyqtari duhet të organizojë procesin gjyqësor, të drejtojë hetimin gjyqësor, në zbatim të detyrimeve procedurale e duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse, duke përfunduar shqyrtimin në një kohë sa më të shpejtë, por duke disiplinuar edhe ai vetë me urdhrat dhe vendimet sjelljen e palëve në gjykim. Në kohën e gjykimit, veç sjelljes së palëve, luan rol edhe mënyra sesi gjyqtari drejton hetimin gjyqësor, duke i lënë zgjidhje pretendimeve të palëve në momentin e duhur procedural, pa shtyrë pafundësisht seancat gjyqësore, për shembull për paraqitje provash, apo kryerje të njëpasnjëshme të akteve të ekspertimit, në rastet kur nevojshmëria e marrjes së tyre është e evidente që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, fakte të cilat janë evidentuar edhe në raportin analitik që është përgatitur nga ish-KLD-ja për organet e rivlerësimit.

Nga ana tjetër, veprimet procedurale të nevojshme, sigurisht që kushtëzojnë në shtyrjet e seancave gjyqësore, por nuk janë ato që drejtojnë gjyqtarin. Administruesi i procesit nuk është Kodi i Procedurës Penale. Ai është një në dorë të gjyqtarit i cili duhet

të përdoret në mënyrë efektive. Nga ana tjetër, cilësia e zgjidhjes së çështjes nuk është tregues i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit.

Caktimi i një numri shumë të lartë seancash në ditë, me qëllim përfundimin e gjykimit brenda afateve të arsyeshme, nuk është tregues i efikasitetit, përkundrazi, ai mund të interpretohet si keqmenaxhim i kohës së gjyqtarit. Nuk e bën një gjyqtar më eficient se një gjyqtar tjetër numri i seancave gjyqësore që zhvillohen në ditë sepse ky vlerësim do të ishte sipërfaqësor, por mënyra sesi gjyqtari organizon punën dhe menaxhon procesin e së cilës çështje. Mund të bësh edhe 30 seanca në ditë dhe të gjitha të shtyhen.

Për sa i përket pretendimeve të tjera lidhur me ngarkesën që ka pasur si kryetare, ato në fakt janë analizuar në projektraport dhe kjo ka sjellë edhe një rritje të nivelit të vlerësimit, qoftë tek rendimenti, qoftë tek respektimi i standardeve orientuese kohore sepse përfitimin që kryetari i gjykatës e ka është i tillë që, norma e likuidimit të çështjeve është 40% më e ulët se ajo e një gjyqtari tjetër që punon në të njëjtën gjykatë.

Pasi kam analizuar edhe kundërshtimet e gjyqtarës, nuk mendoj që është rasti për të propozuar unë si relatore një nivel më të lartë pikëzimi. Nga ana tjetër, pretendimi që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka qenë gjykata ku është zhvilluar projekti “Për një drejtësi pa vonesa” e USAID dhe OSCE-së, zbatimi i suksesshëm i këtij projekti në anën e gjykatës nuk lidhet drejtpërdrejtë me punën e gjyqtarës (jo si kryetare), e theksoj “si gjyqtare”, sepse pikërisht nga ky projekt janë evidentuar edhe këto të meta që sot unë i relatoj lidhur me mënyrën e menaxhimit të çështjeve gjyqësore dhe të zhvillimit të seancave gjyqësore joproductive. Ka qenë pikërisht realizimi i projektit pranë asaj gjykate që ka evidentuar dhe ka propozuar më tej edhe masat (nëse do t’i referohemi edhe propozimeve që kanë bërë dy projektet në kuadër të “Drejtësisë pa vonesa”). Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Do ftoja kolegët nëse kanë ndonjë diskutim, koment?

Nëse jo, kalojmë në votimin e raportit sipas propozimit të ardhur nga relatorja.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi të gjyqtarës {...}, për periudhën 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shumë mirë”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Naureda Llagami: Duke qenë se ora është 11:00, kalojmë në sallë për seancën dëgjimore.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 01.12.2021)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan – (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 16.11.2021).⁴

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:08 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)

⁴ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e treta në rendin e ditës.

8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
5. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*
6. *Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë (në sallë).*
7. *{...}, magjistratë (në sallë).*
8. *Përfaqësues të medias.*

RENDI I DITËS:

6. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan – (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 16.11.2021).

(Futen në sallën e mbledhjes zoti Metani dhe znj. {...}).

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po vijojmë me zhvillimin e seancës dëgjimore në ngarkim të magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shkak të fillimit nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë të procedimit disiplinor ndaj saj.

Kjo seancë dëgjimore është shtyrë nga seanca dëgjimore e datës 16 nëntor, në të cilën nga ana e Këshillit është vendosur që të vijojë diskutimin mbi zbatimin e nenit 136

të ligjit për Statusin, gjithashtu duke i kërkuar edhe qëndrim palëve lidhur me zbatimin e kësaj dispozite.

Shkurtimisht kjo ishte arsyeja për shtyrjen e seancës dëgjimore.

Në seancën e sotshme janë të pranishëm Inspektori i Lartë i Drejtësisë, zoti Metani.

Artur Metani: Po!

Naureda Llagami: Gjithashtu është e pranishme edhe vetë magjistratja, zonja {...}.

{...}: Prezente.

Naureda Llagami: Ndonjë qëndrim, zoti Metani, lidhur me zbatimin e nenit 136 të ligjit për Statusin?

Artur Metani: Po!

Atëherë, në vijim të këtij diskutimi vlerësoj se duhet mbajtur në konsideratë si më poshtë:

“Neni 136 i ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin” krahas dispozitave të tjera që rregullojnë hetimin dhe procedimin disiplinor ndaj magjistratit, synon të përcaktojë në mënyrë të qartë dhe të dallueshme rolet dhe funksionet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshillit gjatë zhvillimit të një procedimi disiplinor.

Neni 136 nga pikëpamja normative, ka natyrë procedurale. Në këtë kuptim, interpretimi i kësaj dispozite duhet të bëhet në harmoni dhe në mënyrë sistematike me parashikimet e nenit 125 (Shtimi ose ndryshimi i objektit të hetimit); nenit 128 (Bashkimi i procedimeve hetimore); nenit 140 (Bashkimi i procedimeve disiplinore); nenit 144 (Ndryshimi ose shtimi i objektit të procedimit disiplinor).

Në mbështetje të nenit 136, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nëse gjatë procedimit disiplinor, vlerëson se ka dyshime të arsyeshme që mund të jetë kryer një shkelje tjetër:

(a) kërkon të ndërpresë procedimin disiplinor, vendos për shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit, kryen hetimin e nevojshëm dhe paraqet raportin e hetimit të mëtejshëm brenda një muaji nga ndërprerja e procedimit; ose (b) i kërkon Këshillit që të shtojë ose ndryshojë objektin e hetimit, nëse nuk është e nevojshme kryerja e hetimeve të mëtejshme, pasi të ketë marrë mendimin e palëve.

ILD vlerëson se nuk është përpara parashikimeve të nenit 136, të ligjit për Statusin, pasi gjatë zhvillimit të procedimit disiplinor nuk është konstatuar asnjë rrethanë apo fakt që mund t'i krijojë ILD një dyshim të arsyeshëm që mund të jetë kryer një shkelje disiplinore. Në këtë kuadër ILD mund të kërkonte: (i) ndërprerjen e procedimit disiplinor; (ii) të shtonte ose ndryshonte objektin e hetimit; (iii) të kryente hetime brenda një muaji; (iv) të paraqiste kërkesën për procedim pranë Këshillit. Në rastin konkret, ILD ka nisur hetimin disiplinor me një objekt të caktuar dhe në varësi të kompleksitetit të çështjes ka përcaktuar dhe afatin e hetimit disiplinor, i cili domosdoshmërisht nuk mund të jete me afat 1-mujor.

Trajtimi i shkeljeve disiplinore të dyshuara është në faza të ndryshme ku njëra është në fazë procedimi disiplinor (ky që kemi sot) dhe tjetra në fazë hetimi. Aplikimi i parashikimeve të nenit 136 dhe nenit 144 të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin”, për t'i sjellë në fazë hetimi, nuk sjellë asnjë pasojë në kuadër të parimit të hetimit kryesisht, të deburokratizimit dhe efijencës, por vetëm ndërlikim dhe vonesa për zhvillimin e procesit disiplinor madje duke marrë ne konsideratë rrethanat e kryerjes së shkeljes disiplinore, deri në parashkrimin e shkeljes disiplinore për të cilën ka nisur procedimi disiplinor.

Në të njëjtën kohë, në zbatim të një vendimmarrjeje të mundshme nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor në bazë të nenit 144 të ligjit, mbi dërgimin e çështjes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ILD duhet të kryejë një procesesh si dhe vendimmarrjesh si bashkimi i procedimeve hetimore (neni 128), shtimin e objektit të hetimit disiplinor (neni 125). Qëllimi i parashikimeve të nenit 125 dhe 128 të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin” është respektimi i të drejtave të magjistratit dhe shmangia e përsëritjes së procedurave hetimore që kanë të bëjnë me të njëjtat fakte ose të njëjtin magjistrat. Në rastin konkret magjistrates {...} i janë garantuar të gjitha të drejtat që ajo gëzon përgjatë hetimit disiplinor në përputhje me ligjin nr. 96/2016, si dhe në lidhje me

shkeljen disiplinore për të cilën ka nisur procedimi disiplinor ILD nuk do kryejë asnjë veprim procedural, pasi kjo çështje është përfunduar tashmë.

Këto dy procese disiplinore nuk janë të ndërlidhur me njëri-tjetrin. Ndërmjet shkeljes disiplinore për të cilën ka nisur procedimi disiplinor dhe shkeljes disiplinore që është në hetim disiplinor nuk ekziston asnjë marrëdhënie varësie ose paragjyqeshmërie, ku një rrethanë apo provë e shkeljes disiplinore për të cilën ka nisur procedimi disiplinor, mund të ndikojë mbi provën apo rrethanë për shkeljen disiplinore për të cilën po zhvillohet hetimi disiplinor.

Në të njëjtën kohë, këto shkelje nuk janë të së njëjtës natyrë (sipas topologjisë dhe natyrës së saj), sipas parashikimeve të nenit 117, pika 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin”, ku mund të zgjatet afati i parashkrimit të shkeljes. Në këtë kuadër nga pikëpamja praktike, nuk sjellë asnjë lehtësi në zhvillimin e procedurave të mëtejshme.”

Si konkluzion, jam kundër zbatimit të nenit 136 në këtë rast.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Metani!

Nga ana juaj?

{...}: Edhe unë do bashkohesha me mendimin e Inspektorit, sepse vërtetë ashtu është, vetëm janë në faza të ndryshme dhe nuk kanë lidhje me njëri-tjetrin.

Mund të vazhdojnë ankime të tjera pa fund emisioni “STOP”, gjobëvënësit {...} me {...}, dhe nuk do të thotë që të ngelemi në të gjitha proceset hapur. Për secilin rast Inspektori le të bëjë veprimet. Edhe unë bashkohem me mendimin e Inspektorit.

Ka pa fund. Gjobëvënësit, po e them njëqind herë, dhe i kam kallëzuar penalisht për gjobëvënës. Edhe atë ditë që unë kam ikur që këtej, kanë nxjerrë në emision dhe ju kam bërë thirrje juve. Kam shprehur lotët e mi, që janë lotë/ndjesi njerëzore, dhe i kam bërë thirrje KLGJ-së që të ndalen për mua. Nuk kanë thënë shkeljet e veta. Ju lutem, ku mund t’i gjej unë të drejtat e mia. Po intimidohem. Kam 5 vjet gjyqtare. Po të drejtat e njeriut? Të paktën edhe hajde, si gjyqtare le të vazhdojnë. Më thoni, një ndihmë dua nga ju. Ku t’i gjej unë të drejtat e mia? Ata shfrytëzojnë ekranin për ditë, një herë në dy ditë.

Kam familje, kam fëmijë. Po më trazojnë jetën në familje. Në punë s'punoj e qetë. Dhe vazhdojnë akoma vetëm për ndonjë shprehje. Edhe mund të jetë gabim, por... pa mbarim. Për ata s'ndalet kush. Për ata pesë kallëzime, të pesta moskallëzime.

Nuk e di! E lë në çmimin tuaj të veproni si të...

Kjo është situata ime.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, pyetje?

Nuk kemi!

{...}: S'e dëgjova.

Naureda Llagami: Po ftoja kolegët nëse kishin ndonjë pyetje ose jo, për të kaluar më tej në konkluzionet përfundimtare.

Artur Metani: A do merret një vendim për nenin 136?

Ilir Toska: Do kalonim në vendimmarrje nëse ju do kishit një kërkesë.

Ju s'keni kërkesë.

Jemi në fazën finale.

Artur Metani: E kam kuptuar unë gabim.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në konkluzionet përfundimtare?

Artur Metani: Po!

Nuk do doja që të zgjatesha me konkluzionet sepse rrethanat e faktit u provuan dhe qëndrimi i magjistrates ishte përgjithësisht... (ka shkëputje të audios) ...i shkeljes, pavarësisht se e la në çmim të KLGJ-së vendimmarrjen.

Në raport me këtë dhe qëndrimin ose ecurinë e gjithë këtij procedimi disiplinor, në përfundim të këtij procedimi do kërkoja KLGJ-së: Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjstrates {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 2, shkronja “dh” e ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe caktimin e masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës në masën 40% për një periudhë kohore prej 6 muaj”.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Po juve?

{...}: Unë do të isha për rrëzimin e kërkesës, për të gjithë sa parashtrova në seancën dëgjimore, qoftë për parashkrimin e ndjekjes disiplinore, qoftë edhe në thelb, s’kam kryer shkelje disiplinore.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Mund të vazhdoni!

(Dalin nga salla e mbledhjes magjistratja znj. {...} dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Diskutimi mbi çështjen vijon vetëm në prezencën e anëtarëve të Këshillit. Pas diskutimeve, ftohen të futen në sallë palët, z. Artur Metani dhe znj. {...} për t’iu komunikuar vendimmarrjen e Këshillit.)

Naureda Llagami: Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: Caktimin e masës disiplinore ndaj magjistratit, të uljes së përkohshme të pagës në masën 20%, për një periudhë prej 6 muajsh.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese, afat i të cilit fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 01.12.2021)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat (shtyrë nga mbledhja e datës 16.11.2021).⁵

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:08 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| <i>12. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>13. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>14. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>15. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>16. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>17. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>18. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |

⁵ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e katra në rendin e ditës.

19. *Alban Toro* (anëtar)
20. *Marçela Shehu* (anëtare)
21. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
22. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
5. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*
6. *Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë (në sallë).*
7. *{...}, magjistrat (në sallë).*
8. *Përfaqësues të medias.*

RENDI I DITËS:

7. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat (shtyrë nga mbledhja e datës 16.11.2021).

(Futen në sallën e mbledhjes zoti Metani dhe z. {...}.)

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Kalojmë në çështjen e radhës së rendit të ditës së Këshillit të Lartë Gjyqësor, që ka të bëjë me zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

Atëherë, çelim seancën dëgjimore.

Është i pranishëm Inspektori i Lartë i Drejtësisë, zoti Metani!

Artur Metani: Gjithashtu është i pranishëm edhe magjistrati, z. {...}.

{...}: I pranishëm.

Naureda Llagami: Atëherë, siç jeni në dijeni, në zbatim të ligjit dhe të rregullores së procedimit disiplinor, po ju shpjegojmë shkurtimisht disa rregulla për zhvillimin e seancës. Secila palë ka të drejtë të paraqesë kërkesat paraprake në këtë seancë, të cilat do shqyrtohen menjëherë pa praninë tuaj.

Në fillim Inspektori i Lartë i Drejtësisë do paraqesë parashtrimet, duke mos përsëritur përmbajtjen e parashtrimeve që ka depozituar me shkrim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Më pas fjala i jepet magjistratit për parashtrimet e tij, edhe ai duke mos përsëritur përmbajtjen e parashtrimeve të depozituara pranë Këshillit.

Pas përfundimit të parashtrimeve tuaja, secili anëtar i Këshillit ka të drejtë për pyetje ndaj Inspektorit dhe magjistratit, po ashtu edhe Inspektori ndaj magjistratit dhe e kundërta.

Pas përfundimit të pyetjeve dhe përgjigjeve, palët ftohen për të dhënë kërkesat përfundimtare të tyre, si dhe për të lënë seancën, e cila do të vazhdojë me diskutimet dhe vendimmarrjen për procedimin, nëse vlerësohet.

Atëherë, pa humbur kohë, fjalën ia jap si fillim Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Artur Metani: Faleminderit, Kryetare!

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Hetimi disiplinor ndaj magjistratit {...} ka filluar pasi shtetasi {...} i është drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën nr. 2968 prot., datë 07.12.2020, me anë të së cilës ka parashtruar se ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat me palë ndërgjyqëse: paditës {...}; i paditur Bashkia Mat; objekti i padisë “Zgjidhje marrëdhënie pune”. Ankuesi {...} ndër të tjera ka pretenduar se vendimi gjyqësor është arsyetuar dhe zbardhur në tejkallim të të gjitha afateve procedurale, duke mos i dhënë mundësi paditësit (ankuesit) për të ushtruar të drejtën e ankimit në gjykatat më të larta.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 2186/5, datë 09.07.2021 ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor mbi bazë ankese ndaj magjistratit {...} me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat” për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d” dhe shkronja “dh” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga veprimet hetimore të kryera dhe provat e mbledhura në funksion të hetimit disiplinor, rezulton se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat është regjistruar çështja civile me nr. 39/313, datë regjistrimi 03.01.2020 me palë ndërgjyqëse, paditës: {...}; e paditur: Bashkia Mat; me objekt të padisë: “Deklarimin e pavlefshëm të ndërprerjes së marrëdhënies së punës..[...]”.

Gjyqtari {...} në përfundim të gjykimit të çështjes objekt hetimi disiplinor ka disponuar me vendimin nr. 126, datë 21.09.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat për rrëzimin e padisë së paditësit {...} si të pabazuar në prova dhe në ligj. Nga fleta e regjistrit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar në kryesekretari, rezulton se vendimi është arsyetuar dhe dosja është dorëzuar në kryesekretari në datë 22.02.2021 për një afat 5 muaj dhe 1 ditë.

Dorëzimi i këtij vendimi në këtë afat tejet të gjatë, rezulton të jetë në kapërcim të afatit 20-ditor të parashikuar në nenin 308, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, afat i cili është tejkaluar plot 6 herë, me një vonesë prej 131 ditë nga shpallja e vendimit përfundimtar, si dhe të afatit 15-ditor të parashikuar nga neni 443, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile për ushtrimin e të drejtës së ankimit nga palët në proces.

Neni 308 i Kodit të Procedurës Civile parashikon shprehimisht se: “Vendimi duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues që kanë marrë pjesë në dhënien e tij. Gjyqtari, mendimi i të cilit ka mbetur në pakicë, shkruan fjalën “kundër” dhe nënshkruan vendimin. Gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se njëzet ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit, deri në njëzet ditë. Arsyetimi i vendimit bëhet nga kryetari i seancës, përveç kur ai del kundër”.

Neni 443, paragrafi parë “Afati i ankimit” parashikon shprehimisht se: “Afati i ankimit në gjykatën e apelit, kundër vendimeve përfundimtare të gjykatës së shkallës së parë, është 15 ditë.”

Nga aktet e marra gjatë hetimit disiplinor rezulton se pasi vendimi është dorëzuar së bashku me dosjen në kryesekretari në datën 22.02.2021, kjo e fundit menjëherë i ka komunikuar vendimin palës paditëse, e cila pasi ka marrë dijeni në datën 01.03.2021 ka paraqitur ankim në datën 10.03.2021. Pas dërgimit të dosjes në Gjykatën e Apelit Tiranë çështja është riregjistruar në datën 29.03.2021 dhe ndodhet në pritje për gjykim.

Duke pasur në konsideratë natyrën e veprimeve apo mosveprimeve të cilat përbëjnë shkelje disiplinore objekt hetimi disiplinor, në rastin konkret duhet të mbahet në konsideratë edhe qëndrimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 5, datë 12.12.2013 i cili argumenton kushtet dhe rrethanat në të cilat shkeljet e kësaj natyre, ngarkojnë me përgjegjësi disiplinore gjyqtarin kur: (i) këto vonesa janë të vazhdueshme, të përsëritura dhe të pajustificuara; (ii) këto vonesa kanë sjellë ose mund të sjellin pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë (sidomos në rastet kur ndaj vendimit që pritet të dorëzohet i arsyetuar është ushtruar ankim); (iii) këto vonesa nuk justifikohen nga ngarkesa e punës që ka gjyqtari apo nga kompleksiteti i çështjeve që ai ka në shqyrtim; (iv) këto vonesa nuk justifikohen nga shkaqe të arsyeshme personale, shëndetësore, familjare, të cilat janë të lidhura direkt me gjyqtarin; (v) këto vonesa janë jashtë çdo afati të arsyeshëm logjik dhe objektiv; (vi) këto vonesa kanë cenuar imazhin e drejtësisë dhe kanë ulur besimin e publikut të drejtësia.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se edhe duke marrë në konsideratë shkaqet e mësipërme objektive (në rast se ato ekzistojnë), vendimet gjyqësore duhet të dorëzohen brenda një afati të arsyeshëm. Në çdo rast duhet të gjenden zgjidhje ligjore brenda institucionit në mënyrë që dorëzimi i tyre të mos marrë më shumë kohë se sa ka marrë vetë procesi gjyqësor, apo ato të mbahen pafundësisht të bllokuara dhe të pa dorëzuara, sepse vonesa të tilla ndikojnë dhe kanë efekt të drejtpërdrejtë tek palët në proces pasi u cenohen këtyre të fundit të drejtat e tyre kushtetuese dhe përfundimisht procesi gjyqësor rezulton në një proces jo efektiv.

Nisur nga natyra e çështjeve të cilat janë trajtuar nga ana e magjistratit {...} në periudhën kohore 01.09.2020-20.02.2021 rezulton se gjyqtari {...} ka përfunduar 179 çështje, nga ku rezulton:

i. 38 çështje të natyrës “urdhra ekzekutimi” të arsyetuara brenda afatit ligjor, për një afat kohor nga 1 deri në 3 ditë.

ii. 4 çështje të natyrës “civile të veçanta” nga të cilat 2 çështje me objekt “përrjashtim gjyqtari” janë arsyetuar për një afat 3 muaj e 21 ditë dhe 3 muaj e 23 ditë, afate këto të tejzgjatura, në kundërshtim me afatin 20-ditor të parashikuar në nenin 308, pika 2 të Kodit të Procedurës Civile, dhe me mundësinë që të kenë tejkaluar vetë procesin gjyqësor për shqyrtimin e tyre. Pra tej afatit 3 mujor rezultojnë të jenë 2 vendime;

iii. 3 çështje të natyrës “vërtetim i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes” të arsyetuara brenda afatit 20-ditor, në intervalin kohor midis 6 deri në 14 ditë.

iv. 19 kërkesa penale me objekt “ulje dënimi”, nga të cilat vetëm 3 janë arsyetuar brenda afatit 5-ditor procedural të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale ndërsa 16 të tjerat jashtë afatit: 1 për 8 ditë, 1 për 18 ditë, 3 për 26 ditë, 1 për 27 ditë, 8 për 29 ditë, 1 për një afat 1 muaj dhe 3 ditë, dhe 1 për një afat 2 muaj dhe 29 ditë. Pra tej afatit 1-mujor rezulton të jetë 1 vendim dhe tej afatit 2-mujor të jetë 1 vendim.

v. 5 kërkesa penale me objekt “lirim me kusht” nga të cilat 3 vendime janë arsyetuar brenda afatit ligjor 5 ditor, ndërsa 2 të tjera jashtë këtij afati: 1 për 27 ditë, dhe 1 për një afat 1 muaj dhe 21 ditë. Pra tej afatit 1 mujor rezulton të jetë 1 vendim;

vi. 10 kërkesa penale paraprake, nga të cilat 4 janë arsyetuar brenda afatit ligjor 5 ditor, ndërsa 6 të tjera jashtë këtij afati përkatësisht: 3 çështje për një afat 1 muaj dhe 3 ditë, 1 çështje për një afat 1 muaj dhe 10 ditë, 1 çështje për një afat 1 muaj dhe 11 ditë dhe 1 çështje për një afat 1 muaj dhe 14 ditë.

vii. 7 kërkesa penale me objekt “masë sigurimi” nga të cilat 2 janë arsyetuar brenda afatit ligjor, ndërsa 5 të tjerat jashtë këtij afati përkatësisht: 1 vendim për 10 ditë, 1 vendim për 11 ditë, 1 vendim për 26 ditë, 1 vendim për 1 muaj dhe 2 ditë, dhe 1 vendim për 1 muaj dhe 13 ditë.

viii. 9 çështje “penale të veçanta” nga të cilat 5 çështje brenda afatit ligjor 5-ditor, dhe 4 prej tyre jashtë këtij afati përkatësisht: 1 vendim për një afat 11 ditë, 1 vendim për një afat 15 ditë, 1 vendim për një afat 22 ditë dhe 1 vendim për një afat 1 muaj dhe 2 ditë.

ix. 16 çështje penale “themeli” nga të cilat 8 vendime brenda afatit ligjor 5-ditor, dhe 8 vendime jashtë këtij afati përkatësisht: 1 vendim për 9 ditë, 2 vendime për 13 ditë, 1 vendim për 19 ditë, 1 vendim për 20 ditë, 1 vendim për 22 ditë, 1 vendim për 1 muaj dhe 7 ditë dhe 1 vendim për 3 muaj dhe 9 ditë.

Nga 68 çështje të natyrës “civile themeli”, duke përjashtuar vendimin objekt hetimi disiplinor nr. 126, datë 21.09.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat rezultojnë të jenë dorëzuar me vonesë 28 vendime gjyqësore nga të cilat: 8 vendime janë arsyetuar për një afat kohor mbi 1 muaj, 12 vendime janë arsyetuar për një afat kohor mbi 2 muaj, 5 vendime për një afat kohor mbi 3 muaj dhe 3 vendime janë arsyetuar për një afat kohor mbi 4 muaj.

Vonesat e evidentuara më lart, si në rastin e vendimit objekt hetimi disiplinor nr. 126, datë 21.09.2020 ashtu dhe rastet e sipërcituara ku përsëritet e njëjta shkelje, rezultojnë të jenë jashtë çdo afati të arsyeshëm logjik dhe objektiv.

Nga të gjitha provat e marra gjatë hetimit rezulton se mosarsyetimet e vendimeve gjyqësore të sipërcituara jo vetëm janë të përsëritura dhe vazhduese, por rezultojnë të jenë gjithashtu dhe të pajustificuara.

Nga hetimi i zhvilluar nuk u konstatuan as kryesisht shkaqe apo rrethana të cilat të justifikojnë vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore duke konkluduar që këto vonesa të jenë të pajustificuara. Gjyqtari {...} nuk rezulton të ketë mungesa në detyrë në këtë periudhë, referuar listprezencës së përcjellë nga ana e gjykatës, e cila të ketë ndikuar në mosarsyetimin e vendimeve gjyqësore në kohë. Për pasojë gjatë hetimit disiplinor nuk rezultoi që vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore të justifikohen nga shkaqe të arsyeshme personale, shëndetësore, familjare, të cilat janë të lidhura direkt me gjyqtarin {...}.

Nga të dhënat e administruara gjatë hetimit, rezulton se çështjet civile të gjykuara dhe për të cilat është marrë vendim nga ana e magjistratit {...} për nga natyra e objektit të padisë apo të kërkesës si: vërtetim fakti juridik, zgjidhje martesë, pavlefshmëri titulli

ekzekutiv, përmbushje detyrimi kontraktor, korigjim akti, apo tjetër, nuk rezultojnë aspak të jenë të një niveli kompleks apo të vështirë dhe asnjë prej vendimeve të arsyetuara nuk rezulton të jetë voluminoz në atë përmasë që të justifikojë vonesën.

Ngarkesa në punë e magjistratit {...} referuar Vendimit nr. 261/10 datë 14.04.2010 “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve” Aneksi 1, pika 3, shkronja “g”, rezulton të jetë mbi standardin e çështjeve të përcaktuara për gjykim në 1 vit gjithsesi, duke iu referuar natyrës së çështjeve objekt gjykimi, ngarkesa në punë nuk është e asaj përmase sa të justifikojë vonesat e konsiderueshme, pasi çështjet nuk janë aspak komplekse, që mund të kërkojnë kohë më të gjatë në arsyetim, duke marrë si shembull objektin e gjyqimit: zgjidhje kontrate pune, por dhe për shembull ulje dënimi, apo përjashtim gjyqtari, të cilat për nga natyra e tyre pavarësisht ngarkesës nuk justifikojnë vonesat respektive prej 2 apo 3 muaj.

Nga sa më sipër provohet se nga ana e magjistratit {...} është kryer shkelja disiplinore e parashikuar nga ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 102, pika 1, shkronjat “d” të ligjit nr. 96/2016, i cili parashikon se: “1. Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si më poshtë:... (d) vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale...[...]”.

Për sa i përket shkeljes tjetër të dyshuar disiplinore për të cilën ka filluar hetimi disiplinor të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 96/2016, në rastin konkret konstatohet se provat janë të pamjaftueshme për të provuar kryerjen e saj.

Vonesa në arsyetimin e vendimit ka sjellë si pasojë të drejtpërdrejtë zvarritjen e pajustificuar të procesit gjyqësor, pjesë përbërëse e të cilit është dhe vendimi i arsyetuar, si dhe vonesa në komunikimin e vendimit palëve ndërgjyqëse, paraqitjen e ankimit nga ana e tyre, si dhe shqyrtimin e këtij ankimi nga gjykata më e lartë, pjesë përbërëse e vetë procesit gjyqësor. Nga ana tjetër nga hetimi i kryer nuk u provua lidhja shkakësore e drejtpërdrejtë midis mosveprimit të magjistratit dhe një dëmi real për palët ndërgjyqëse përtej asaj të zvarritjes së pajustificuar të procesit gjyqësor ardhur si pasojë e vonesave të përsëritura në arsyetimin e vendimeve gjyqësore të relatuar më lart.

Në analizë të kriterit “mbi llojin dhe rrethanat e shkeljes” rezulton se nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor, janë ndërmarrë veprime që përbëjnë një mospërbushje të rregullt të detyrës, në shkelje të afateve procedurale civile të arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke tejkaluar afatet tej çdo logjike, pavarësisht çështjeve me vështirësi të një niveli mesatar.

Në analizë të kriterit të “shkallës së fajësisë dhe motivi”, nga të dhënat e grumbulluara gjatë hetimit disiplinor, provohet se veprimet e magjistratit {...} janë kryer të paktën me pakujdesi në formë neglizhence e ardhur edhe si pasojë e ngarkesës, e përsëritur në rastet e analizuara hollësisht më lart. Nuk u provua që këto vonesa të jenë kryer më dashje me qëllim krijimin e vonesave për palët për të ushtruar ankim ndaj vendimmarrjeve të gjyqtarit {...}, apo qëllime të tjera.

Ndërsa në analizë të kriterit “pasojat e shkeljes” në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor, rezulton se si pasojë e shkeljes disiplinore të kryer nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor është cenuar prestigji i figurës së gjyqtarit, si dhe është cenuar besimi i publikut të drejtësia.

Në referim të jurisprudencës së Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese, gjykatat kanë detyrimin që të respektojnë parimin e rëndësishëm “të përfundimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm”. Sa më sipër, si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor, garanton mbrojtjen e të gjitha palëve të përfshira në procesin gjyqësor ndaj “vonesave të tepruara procedurale”, që në administrimin e drejtësisë rrezikojnë të drejtat e palëve dhe shtetin e së drejtës. Një drejtësi jo efikase dhe e vonuar çon në dëmtimin e besimit të qytetarëve tek institucionet e shtetit. Drejtësia e vonuar është e njëjtë me drejtësinë e mohuar.

Për sa më sipër, kërkojmë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të administrojë provat e paraqitura nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në këtë procedim disiplinor dhe në mbështetje të nenit 105, pika 1, shkronja “c”, nënndarja “i” dhe nenit 108 të ligjit nr. 96/2016, të vendosë:

Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për

shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe caktimin e masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 % për një periudhë jo më të gjatë se një vit”.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Magjistrati!

{...}: Përshëndetje!

Së pari, dua t’ju sqaroj mungesën time të datës 16 nëntor 2021, ku ishte planifikuar seanca, pikërisht kjo seancë që po zhvillohet sot. Unë në atë datë, për motive shëndetësore nuk kam mundur të merrja pjesë. Kam qenë i shtruar në spital disa ditë. Mund të them që edhe sot në këtë seancë unë jam me raport mjekësor por zgjova të jem i pranishëm, se s’jam në atë pikë të shëndetit që të mos përballojë këtë seancë të nderuar. Shkurtimisht kjo ishte arsyeja pse unë nuk isha në seancën e datës 16.

Për të kaluar më tej në lidhje me kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zotit Metani. Unë gjithë aktivitetin tim si gjyqtar e kam zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat dhe besoj jeni në dijeni që aktualisht jam i shkarkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit më datë 25 të muajit nëntor. Nuk e di ka ndonjë rëndësi ky fakt apo jo, por le të vlerësohet nga trupa e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në vijim, unë jam njohur me kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe të them të drejtën ndihem shumë keq, realisht. Kur e kam lexuar këtë kërkesë, e kam vuajtur sepse është një procedim që nga ana formale nuk është dhe nuk qëndron. Nuk është vetëm një vendim, por janë një sërë vendimesh të arsyetuara me vonesë. Janë një sërë vendimesh apo çështjesh të shqyrtuara dhe të përfunduara përtej afateve që ligji procedural civil dhe penal kërkon që të shqyrtohen dhe të jepet një vendim përfundimtar. Por, si shkelja, si fakti i mosdorëzimit të vendimeve të zbardhura në kohë ashtu edhe shkeljet e tjera që s’janë përmendur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, lidhen me periudhën e vitit 2020 dhe ’21.

Ka ndodhur që në Gjykatën e Matit për vitin 2020 janë larguar, për shkaqe objektive, dy gjyqtarë, i ndjeri {...} dhe gjyqtari {...} për një pezullim 1-vjeçar, dhe krahas ngarkesës normale që kishim si gjyqtarë, jemi ngarkuar, unë bashkë me kolegun tjetër të Gjykatës Mat, me ngarkesat e të dy gjyqtarëve. Me ngarkesën e një gjyqtari jam ngarkuar në muajin qershor dhe me ngarkesën e gjyqtarit tjetër jemi ngarkuar në muajin shtator, fillim shtatori. Pra përveç ngarkesës time normale të punës brenda një periudhe dymujore kam marrë edhe ngarkesën e lënë nga dy kolegët e Gjykatës Mat.

Ka qëlluar që në muajin gusht, deri më 15 gusht kam qenë i planifikuar në punë, kam punuar deri më 15 gusht, dhe me 16 gusht kam filluar lejen vjetore të vitit 2020.

Ditën e parë të lejes unë jam infektuar me virusin COVID bashkë me bashkëshorten time, që na ka mbajtur në gjendje të rëndë të paktën 3 javë. Në vijim, gjatë muajve të vjeshtës, pa përjashtim të gjithë pjesëtarët e familjes time, fëmijët dhe një fëmijë i fëmijës, janë prekur nga infeksioni. E them këtë për të treguar se në çfarë shtate personale kam qenë, dhe shëndetësore, edhe shpirtërore pse jo.

Më 1 shtator jam paraqitur në punë. Kam qenë gjyqtar i gatshëm. Kam filluar punën shumë i lodhur, shumë i pamundshëm, shumë i paaftë për ta kryer detyrën, por dy gjyqtarë ishim dhe ishim të detyruar deri në frymën e fundit të kryenim atë detyrë që kishim.

Sigurisht, gjatë muajve të fundit, nga shtatori deri në fund të vitit 2020, më ka ngelur (për ato arsye që thashë më sipër: ngarkesa e menjëhershme dhe gjendja shëndetësore e imja) pa arsyetuar në kohë vendimet për të cilat bën fjalë Inspektori.

Naureda Llagami: Ju lutem, vetëm shkurtimisht, gjëra të tjera që keni përveç atyre që keni depozituar.

{...}: Mirë!

Pa dashur t'ju marrë shumë kohë, dëshiroj të them që ky procedim ka nisur (unë e them dhe ndoshta s'është e vërtetë, unë e them dhe e besoj shumë) nga një ankues i sajuar. Unë nuk e kam provën 100% që t'ia vë në dispozicion Këshillit të Lartë Gjyqësor, as Inspektorit, është një ankues i sajuar aty nga brenda institucionit, për fat të keq, dhe

bashkë me vendimin për të cilin ankohet ankuesi N.B., në fakt, nënkryetari i gjykatës ka bërë edhe një informacion tek Inspektori për një sërë vendimesh të padorëzuara dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë zoti Metani, me shkresën përkatëse të datës 9 prill 2021, ka vendosur “Arkivimin e ankesës pas verifikimit”, pjesë të cilave ka qenë edhe vendimi 126 i shtatorit të vitit 2020.

Në fakt, me thënë të drejtën, kur e kam lexuar shkresën e zotit Metani, me shpirt e kam falënderuar shumë sepse mu duk se më privilegjoj duke arsyetuar e duke përshkruar ato rrethana për të cilat përballen sot gjyqtarët apo sistemi i drejtësisë në përgjithësi (me ngarkesën, me problemet, me infeksionin, etj.).

Unë këtë doja të thosha. Mund të kishte edhe më shumë por unë po e ndërpres fjalën time. Përgjithësisht këto kanë qenë arsyet. Për të tjerat ia lë Këshillit të Lartë Gjyqësor të arsyetojë. Unë s’kam gjë tjetër. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nga kolegët pyetje?

Medi Bici: Thatë që keni qenë me COVID në gusht të vitit 2020.

Keni ndonjë dokument nga mjeku i familjes?

{...}: Dokument?

Medi Bici: Jepet një shkresë, ku mund të të japin edhe 20 ditë leje.

Në përfundim të COVID-it të jep një dokument mjeku i familjes.

{...}: Unë thashë që me datë 16 kam konstatuar infektimin bashkë me bashkëshorten time dhe kam qëndruar... Sigurisht unë jam trajtuar, kam bërë ekzaminime, kam bërë vizita, kam marrë mjekime, kam komunikuar me mjekun e familjes. Sigurisht që kjo është një gjë jashtë mendsh që ta sajoj dhe ta... Mundem ta marrë nga mjeku i familjes një konfirmim të tillë. Pa diskutim. Madje, kur po bisedoja me bashkëshorten, po më tregonte bashkëshortja mesazhet sepse ishte e pamundur për të komunikuar për të dalë nga banesa. Kemi komunikuar në mënyrë elektronike me mjekun e familjes, komunikim të vazhdueshëm për këshilla, për mjekimin që duhet të merrim, etj., etj. Nuk

diskutohet. Është fundi i botës në qoftë se unë them kam qenë i infektuar dhe të mos kem qenë. Ju lutem, këtë besojeni.

Medi Bici: Sa ka qenë ngarkesa normale për gjyqtar kur ju keni qenë me organikë të plotë?

{...}: Edhe një herë?

Medi Bici: Sa ka qenë ngarkesa për gjyqtar kur ju keni pasur organikën e plotë? Sa çështje kishit në dorë? Para vitit 2020, pyes.

{...}: Për 2020?

Medi Bici: Para 2020.

{...}: Sigurisht unë nuk jam i gatshëm ta them një shifër të saktë. Por ngarkesa e gjyqtarëve të Gjykatës Mat shkon rreth 1200 çështje në vit. Sigurisht ¼ e asaj ngarkese... Por të thashë, ka qenë veçori në 2020, në mars kemi ndërprerë punën, po në atë muaj ka vdekur një koleg i yni dhe në qershor kur janë rihapur gjykatat na është dhënë ngarkesa e kolegut. Në korrik është larguar gjyqtari tjetër dhe në shtator kemi marrë ngarkesën e tij. Ky ka qenë njëri prej shkaqeve që ka sjellë arsyetimin me vonesë. Të them të drejtën kam qenë i angazhuar t'i përfundoj gjykimet, të mbaroj atë dilemën e gjykimit, që mbaron edhe stresi i vajtje-ardhjeve i seancave gjyqësore në gjykatë, palëve. Aty janë shumë vendime të dorëzuara me vonesë, por mënyra si kam punuar unë, vështirë gjendet një qytetar apo një palë të ankohet për punën time si gjyqtar (kaq vite që punoj atje). Unë them jam shumë i respektuar dhe nuk e di si e gjetën këtë ankuesin, si e sajuan që të bënte këtë ankesën, mbi të cilën ka ardhur gjithë kjo histori.

S'jam i saktë sa ka qenë ngarkesa përfundimisht zoti Bici, por një ngarkesë që, të paktën unë, e filloj punën në 8:30 dhe në të shumtën e rasteve kam mbyllur seancat gjyqësore në 15:30, pa pushim, pa ndërprerje. Unë e kam kalendarin aty, është "i gjallë".

Medi Bici: Për vitin 2020, ke qenë i komanduar në gjykata të tjera, përveç gjykatës së Matit?

{...}: Plot komandime. Në katër gjykata të tjera. (Përsëritet fjalja).

Në Dibër, në Kurbin, në Lezhë, dhe në Krujë.

Dy ditë i kishim të planifikuara në javë, ditë të mërkurë dhe të enjte, të destinuara çdo të mërkurë, të enjte, për të gjykuar gjykime jashtë gjykatës ku unë kryeja aktivitetin e përditshëm, të zakonshëm të punës.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Pyetje tjetër nga kolegët?

Brikena Ukperaj: Duke marrë shkas edhe nga ajo që... (shkëputet audio dhe nuk dëgjohet fjala e zonjës Ukperaj), sot zoti {...} është i shkarkuar me vendim të organeve të rivlerësimit, a mendoni se ky fakt afekton këtë procedurë disiplinore, nisur kjo edhe nga fakti i masës disiplinore që ju keni propozuar?

Artur Metani: Jo! Unë jam persistent në qëndrimin që kam mbajtur edhe në raste të tjera në Këshill. Procedura e ndjekur nga KPK-ja apo organet e vetting-ut nuk mund të pezullojë procedurat që ndjek Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshilli, për sa kohë që nuk flasin apo nuk trajtojnë të njëjtat fakte. Sa kohë nuk trajtojnë të njëjtat fakte, ligji është i drejtpërdrejtë në këndvështrimin tim, që procedurat duhet të vazhdojnë pavarësisht se janë paralele për fakte të tjera.

Naureda Llagami: Tjetër diskutim?

Për të administruar akte ose prova?

Jo!

Atëherë, lidhur me vijimin e procesit, ju lutem mund të vazhdoni, për të lejuar Këshillin të vlerësojë.

(Dalin nga salla e mbledhjes magistrati z. {...} dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Diskutimi mbi çështjen vijon vetëm në prezencën e anëtarëve të Këshillit. Pas diskutimeve, ftohen të futen në sallë palët, z. Artur Metani dhe z. {...}, për t'iu njoftuar vendimmarrjen e Këshillit.)

Naureda Llagami: Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: Pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 478, datë 25.11.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Kundër këtij vendimi ligji nuk lejon ankim.

Një kopje e vendimit i njoftohet subjekteve të procedimit disiplinor, magjistratit z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

Me kaq është e mbyllur seanca.

Faleminderit!

*Mbledhja vijon me çështjen e cila do të zhvillohet vetëm në prezencë të anëtarëve të Këshillit.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 01.12.2021)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për vitin 2019, relator z. Erjon Muharremaj.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:08 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 10. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për vitin 2019, relator z. Erjon Muharremaj.

Rifillon sërish mbledhja nëpërmjet platformës “online”, me shqyrtimin e çështjes ku relator është zoti Muharremaj.

Erjon Muharremaj: Faleminderit!

Sa i përket vlerësimit për gjyqtaren {...} për periudhën 1 janar 2019 – 31 dhjetor 2019, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, dhe njëkohësisht kryetare e kësaj gjykate, do të ndalem vetëm në ato aspekte për të cilat gjyqtarja ka paraqitur kundërshtimin e saj dhe për shkak se juve jeni njohur prej kohësh me aktet e vlerësimit.

Në lidhje me kriterin e parë të “Aftësive profesionale të gjyqtarës”, propozimi është për vlerësimin me 90 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Gjyqtarja nuk ka asnjë kundërshtim në lidhje me këtë vlerësim.

Sa i përket kriterit të “Aftësive organizative të gjyqtarës”, në lidhje me treguesit e “Respektimit të afateve ligjore” është propozuar që gjyqtarja të vlerësohet në nivelin 21-30%, duke e pikëzuar me 9 pikë, pavarësisht se referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore, për periudhën e vlerësimit të vitit 2019, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 67 çështje për të cilat

ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, nga të cilat 27 prej tyre janë jashtë këtij afati. Pra gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 40.29% të çështjeve jashtë afatit ligjor dhe nëse do të ishte bërë thjesht një përllogaritje matematikore, atëherë kjo vlerë do të përkonte me nivelin 40% dhe do të pikëzohet me 3 pikë.

Por në projektraportin e vlerësimit është bërë analizë e detajuar e të dhënave statistikore, duke përjashtuar nga kjo përllogaritje çështjet në të cilat mosrespektimi i afateve ligjore ka ardhur për shkak të shortimit me vonesë të çështjes apo çështjet të cilat nuk kanë përfunduar në afat për shkak të lejes vjetore. Për rrjedhojë, nga kjo llogaritje është vlerësuar se vetëm 24 prej tyre kanë përfunduar tej afatit ligjor, nga 67 çështje që kanë afat ligjor të parashikuar, për përfundimin e tyre, ose e shprehur në përqindje 35.82% të çështjeve. Po kështu, duke pasur parasysh kohën relativisht të shkurtër të tejkalimit të afatit ligjor në shumicën e çështjeve të analizuara, në projektraportin e vlerësimit është propozuar që gjyqtarja të vlerësohet për këtë tregues në nivel më të lartë pikëzimi se ai që i përket përqindjes së çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit. Prandaj është propozuar pikëzimi me 9 pikë.

Lidhur me këtë tregues, gjyqtarja ka paraqitur kundërshtimet e saj, si dhe provat në mbështetje të tyre (po citoj):

“Ka parashtruar ecurinë procedurale dhe shkaqet që kanë çuar në tejkalimin e afatit ligjor në çështjet me nr. 18, 373, 461, 19, 2/66, 3/267, 46, 65, 80, 82, 136, 61, 372, 373, 551, 552, 563, 577, 714 akti. Ka parashtruar gjithashtu se duke pasur parasysh ngarkesën shumë të madhe që mbulon Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, nga ana e saj si gjyqtare janë gjykuar për vitin 2019 rreth 485 çështje, nga 590 që i kanë rënë me short. Në vlerësimin e afateve të gjykimit vetëm për 67 çështje, nga 485 në total nga ana e saj, duhen mbajtur parasysh edhe shumë faktorë, jo thjesht të bëhet një përllogaritje matematikore, kur ka filluar dhe kur ka mbaruar çështja pa i hyrë shkaqeve të shtyrjeve, nëse këto shkaqe kanë qenë të ndërvarura nga gjyqtari, apo kanë qenë për shkaqe procedurale për të cilat gjyqtari ka qenë i detyruar ta shtyjë një seancë, për të realizuar një hetim sa më të plotë të çështjes dhe marrjen e të gjitha provave për të zgjidhur një çështje konform ligjit, duke shmangur prishjen e këtij vendimi nga gjykatat më të larta, për moskryerjen e një hetimi të plotë. Gjithashtu gjyqtarja argumenton se seancat janë shtyrë

për moskonfirmim të marrjes dijëni të palëve, pasi nuk ka ardhur përgjigjja e fletëthirrjes së dërguar me postë, kërkesës së palëve për të pasur avokatin e tyre mbrojtës (shkak për të cilin vendimi mund të prishte nga gjykata më e lartë për mosdhënien mundësi palës për të realizuar një mbrojtje efektive), për moskthimin e përgjigjes për shkresat e drejtuara institucioneve shtetërore, për t'i lënë kohë ekspertit të kryejë aktin e ekspertimit, për t'i lënë kohë palëve të njihen me këtë akt ekspertimi, për shkak të moskthimit të përgjigjes nga komisarati për njoftimin e të pandehurit apo dëshmitarit, etj. Të gjitha këto shtyrje janë për shkak të veprimeve procedurale që gjyqtari duhet të kryejë. Gjyqtari nuk mund të mbyllë shqyrtimin gjyqësor pa i ardhur një përgjigje për një informacion të kërkuar, pa u kryer akti i ekspertimit dhe pa u njohur palët me to, pa u pyetur dëshmitari në një proces penal, etj. Prandaj çmon gjyqtarja se vlerësimi i gjyqtarit nuk duhet të mbështetet thjesht në numra ditësh, se për sa ditë e ka përfunduar një gjykim, por duhet parë edhe cilësia e zgjidhjes së çështjes, nëse kjo çështje është cenuar nga gjykatat më të larta apo jo, shpejtësia në arsyetimin e këtij vendimi, për t'i dhënë mundësi palës për një gjykim sa më efektiv dhe brenda shkaqeve të arsyeshme. Sipas vlerësimit tim, thotë gjyqtarja, duhen analizuar shkaqet për të cilat janë shtyrë këto seanca dhe çështja është gjykuar jashtë afateve, nëse këto shkaqe kanë pasur lidhje me gjyqtarin apo për shkaqe procedurale të pavarura prej tij.

Për sa më sipër, gjyqtarja çmon se duhet të kihet parasysh pikë së pari ngarkesa në punë, pasi nuk mund të bëhet një vlerësim i njëjtë, thjesht duke parë datat në kalendar të një gjyqtari që gjykon 50 çështje në vit, me një gjyqtar që gjykon rreth 500 çështje në vit, aq më tepër që vlerësimi i afateve është bërë duke marrë për bazë vetëm 67 çështje, nga 485 të shqyrtuara gjatë vitit 2019. Në vlerësimin e gjyqtares duhet të kihet parasysh fakti që nga muaji dhjetor i vitit 2013 e në vijim, ushtrij edhe detyrën e kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, e cila nënkupton se nga ana ime, përveç veprimeve si gjyqtare, janë kryer shumë veprime administrative dhe janë marrë shumë vendime dhe urdhra për të mundësuar mirëorganizimin e punës së përditshme dhe duke mundësuar aksesin e plotë të palëve në gjykatë, gjë e cila nënkupton kohë fizike të shpenzuar.

Me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor jam zgjedhur me short si anëtare e Kolegjit Zgjedhor. Në zbatim të nenit 149 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

ky fakt duhet të kihet parasysh si vlerë e shtuar në përvojë për efekt vlerësimi me qëllim të ngritjes në detyrë.” – këtu e përfundoj citimin.

Lidhur nga sa parashtrohet nga gjyqtarja, evidentohet se çështjet për të cilat gjyqtarja ka paraqitur provat lidhur me shkakun e tejkalimit të afatit ligjor, janë marrë në analizë edhe në raportin e vlerësimit dhe i janë zbritur përqindjes fillestare prej 40.29% që ka rezultuar nga të dhënat statistikore. Po kështu në projektraportin e vlerësimit nuk është bërë thjesht një vlerësim matematikor i të dhënave statistikore, por është bërë një analizë logjike e të dhënave burimore, duke iu referuar ngarkesës në punë të gjyqtares, pra 485 çështje të gjykuara nga 590 që i janë caktuar; kohës relativisht të shkurtër të tejkalimit të afateve ligjore në shumicën e çështjeve të analizuar si dhe në disa raste, vonesa në shqyrtim ka ardhur si pasojë e shortimit me vonesë të çështjeve. Prandaj është propozuar që për këtë tregues gjyqtarja të vlerësohet në një nivel më të lartë pikëzimi sesa do i përkiste nëse do të merrej strikt përqindja e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit. Kjo, duke u bazuar edhe në parimin e proporcionalitetit, objektivitetit, përballë detyrueshmërisë ligjore që një kategori çështjesh duhet të shqyrtohen brenda afateve të përcaktuara.

Lidhur me pretendimin e gjyqtares se në vlerësimin e saj duhet të kihet parasysh fakti se nga muaji dhjetor i 2013 vijon detyrën e kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, e cila nënkupton që përveç veprimeve si gjyqtare, janë kryer edhe veprime administrative dhe janë marrë shumë vendime dhe urdhra për të mundësuar mirëorganizimin e punës së përditshme dhe aksesin e plotë të palëve në gjykatë, gjë e cila nënkupton kohë fizike të shpenzuar, theksoj që kjo ngarkesë e gjyqtares është marrë parasysh në treguesin tjetër 2Aç “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore”, ky gjyqtarja është propozuar të vlerësohet në nivelin mbi 93-99%, me 8 pikë, pavarësisht se norma e likuidimit të çështjeve rezulton 82.2%, pra dy shkallë më lartë është propozuar ose thënë ndryshe 4 pikë më tepër seç rezulton nga të dhënat statistikore. Kjo duke iu referuar ngarkesës së punës si dhe faktit që gjyqtarja rezulton të ketë përfunduar dukshëm më tepër se 50% të standardit minimal të ngarkesës ku duket që ka përfunduar 241% më tepër se standardi sasior i punës të përcaktuar për kryetaren e gjykatës.

Prandaj, bazuar në sa parashtrova më sipër, vlerësoj se nuk ka vend për ndryshimin e propozimit lidhur me nivelin e vlerësimit, duke i qëndruar propozimit të bërë në projektraportin e vlerësimit, për ta pikëzuar me 9 pikë.

Sa i përket “Plotësimit të standardeve minimale kohore”, është në nivelin 0 – 10%, propozimi për ta pikëzuar me 5 pikë.

“Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje” është më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve, propozimi për 5 pikë.

Sa i përket “Rendimentit të përfundimit të çështjeve gjyqësore”, siç u shpreha pak më sipër, rezulton të ketë gjykuar 485 çështje nga 590 që i janë caktuar. Në mënyrë strikte 82.2% do të duhej të pikëzohej me 4 pikë, por për të gjitha arsyet që përmenda, duke iu referuar faktit që ka gjykuar 241% më tepër sesa standardi që i takonte si kryetare e gjykatës, është propozuar pikëzimi me 2 shkallë më lartë, pra nga 4 në 8 pikë, duke iu referuar përqindjes së çështjeve “mbi 93-99%”.

Për sa i përket “Kohës mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor”, është më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve – 12 pikë.

“Numri mesatar i seancave gjyqësore”, “1-3 seanca”, propozimi për 15 pikë.

“Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale”, aftësia “shumë e lartë”, pikëzimi 20 pikë.

“Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes”, aftësia “shumë e lartë”, 5 pikë.

“Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes”, aftësia “shumë e lartë”, 10 pikë.

Në total, për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarës” propozohet vlerësimi me 89 pikë, niveli i vlerësimit "Shumë mirë".

Në lidhje me “Etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale” nuk ka asnjë tregues për cenimin e etikës, prandaj propozohet pikëzimi maksimal prej 100 pikësh, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Ndërsa, sa i përket “Aftësive personale dhe angazhimin profesional”, propozimi është për 91 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Për shkak se nuk rezulton që në treguesin e “Disponueshmërisë së gjyqtarës për të udhëhequr gjyqtarët...” nuk rezultojnë të dhëna.

Sa i përket “Pjesëmarrjes së gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale”, gjithashtu nuk rezultojnë të dhëna.

Dhe sa i përket “Publikimeve ligjore akademike” gjithashtu nuk rezultojnë të dhëna.

Për këtë arsye propozohet që për këtë kriter të pikëzohet me 91 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Në total, vlerësimi i përgjithshëm, propozimi është që të pikëzohet me 370 pikë dhe niveli i vlerësimit "Shumë mirë". Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Muharremaj!

Kalojmë, nga kolegët nëse kanë ndonjë koment, vlerësim?

Nëse jo, atëherë kalojmë në votimin e projektraportit sipas propozimit të ardhur nga relatori.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- B. Aftësitë organizative – “Shumë mirë”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 01.12.2021)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për “Përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, kancelare në detyrë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për shkak të dorëheqjes”, relator E.Muharremaj

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:08 dhe mbaroi në orën 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)

9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashë.*
3. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
5. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit për “Përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, kancelare në detyrë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për shkak të dorëheqjes”, relator E.Muharremaj

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e fundit të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, kancelarë në detyrë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Për më shume detaje fjalën ia jap zotit Muharremaj.

Erjon Muharremaj: Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr.496, datë 21.10.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kancelarëve në detyrë”, ka filluar procedurën e verifikimit për plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, verifikimin e pasurisë dhe figurës për kancelarët në detyrë, ndër të cilët edhe për znj. {...}, kancelare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Znj. {...} me shkresën me nr. {...} prot, datë 19.11.2021 ka paraqitur aktin e dorëheqjes së saj nga detyra e kancelares, për shkak të angazhimeve të saj personale dhe familjare, duke kërkuar miratimin e kërkesës për heqje dorë, në kushtet e pamundësisë për vazhdimin e marrëdhënies aktuale të punës.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 90, pika c) të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ka në kompetencë të tij ndër të tjera emërimin e kancelarëve të gjykatave.

Lidhur me vijimin e marrëdhënieve të punës dhe përfundimin e saj, në nenin 80 të ligjit nr. 98/2016, parashikohet se: “3.Organi kompetent për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor është Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë është Këshilli i Gjykatës ku ai ushtron detyrën”.

Në këtë dispozitë theksohet se ndërprerja e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor i nënshtrohet rregullave të parashikuara në ligjin “Për nëpunësin civil”, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Në nenin 64, të ligjit nr. 152/2013 “Për statusin e nëpunësit civil”, i ndryshuar përcaktohet se: “2. Dorëheqja nuk motivohet dhe i prodhon efektet 30 ditë nga data e paraqitjes së saj. ...”

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në kushtet kur për shkak të dorëheqjes së paraqitur nga kancelarja në detyrë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër znj. {...}, vlerësohet se është vërtetuar një ndër shkaqet ligjore të përfundimit të marrëdhënies së punës, sipas parashikimeve të nenit 64, të ligjit nr. 152/2013, “Për statusin e nëpunësit civil”, i ndryshuar, marrëdhënia e punës duhet të deklarohet e përfunduar për shkak të dorëheqjes.

Në lidhje me këtë, në pikën e parë të projektvendimit është përcaktuar disponimi për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për znj. {...}, për shkak të vërtetimit të një prej shkaqeve ligjore të përfundimit të marrëdhënies së punës.

Në pikën e dytë të projektvendimit është përcaktuar njoftimi i vendimit znj. {...}, si dhe i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Në pikën e tretë të projektvendimit është parashikuar fillimi i efekteve të këtij vendimi, në kushtet kur dispozita në rastet e dorëheqjes së pamotivuar parashikon një afat 30-ditor nga data e paraqitjes së saj. Pra vendimi i fillon efektet e tij në datën 22.12.2021.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Muharremaj!

Nëse nuk kemi diskutime kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, kancelare në detyrë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për shkak të dorëheqjes.

2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet znj. {...}, si dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

3. Ky vendim i fillon efektet e tij në datën 22.12.2021.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

Me kaq po mbylлим mbledhjen e sotshme.

Faleminderit!

Mirupafshim!

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor